



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN**

Elbasan, më _____.____.2023

Procesverbal -Tipi i kontrates - Shërbim

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROCEDURËS-“Shpenzime për prerje dhe transport dru zjarri”, i ndarë në lote si më poshtë:

- Loti I: “Shpenzime për prerje dhe transport dru zjarri” në ekonominë pyjore: Shpat-1, ngastra 14/a dhe ekonominë pyjore F.Kuqe Zavalinë, ngastra 104/c
- Loti II: “Shpenzime për prerje dhe transport dru zjarri” në ekonominë pyjore: Shpat-2, ngastra 31/a dhe ngastra 33/a
- Loti III: “Shpenzime për prerje dhe transport dru zjarri” në ekonominë pyjore: Zalli Korrës, ngastra 1/a dhe ngastra 27/a
- Loti IV: “Shpenzime për prerje dhe transport dru zjarri” në ekonominë pyjore: Shpat-1, ngastra 48/a.

LLOJI PROCEDURËS- “Procedurë e hapur –shërbim”

VLERA TOTALE E FONDIT LIMIT -27,661,022 (njëzet e shtatëmilion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e njëmijë e njëzet e dy) **lekë pa t.v.sh.**

- **Loti I: “Shpenzime për prerje dhe transport dru zjarri” në ekonominë pyjore: Shpat-1, ngastra 14/a dhe ekonominë pyjore F.Kuqe Zavalinë, ngastra 104/c me fond limit 10,798,618** (dhjetëmilion e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetëmijë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë) **lekë pa t.v.sh.**
- **Loti II: “Shpenzime për prerje dhe transport dru zjarri” në ekonominë pyjore: Shpat-2, ngastra 31/a dhe ngastra 33/a me fond limit 5,533,537** (pesëmilion e pesëqind e tridhjetë e tremijë e pesëqind e tridhjetë e shtatë) **lekë pa t.v.sh.**
- **Loti III: “Shpenzime për prerje dhe transport dru zjarri” në ekonominë pyjore: Zalli Korrës, ngastra 1/a dhe ngastra 27/a me fond limit 8,826,257** (tetëmilion e tetëqind e njëzet e gjashtëmijë e dyqind e pesëdhjetë e shtatë) **lekë pa t.v.sh.**

- **Loti IV: “Shpenzime për prerje dhe transport dru zjarri” në ekonominë pyjore: Shpat-1, ngastra 48/a me fond limit 2,502,610 (dymilion e pesëqind e dymijë e gjashtëqind e dhjetë) lekë pa t.v.sh.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):77220000-8 - Shërbime të trajtimit të lëndëve drusore

Ne baze të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontrator Bashkia Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipercituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 8

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 02 Datë 09.06.2021 te miratuara nga APP.

Loti I: “Shpenzime për prerje dhe transport dru zjarri” në ekonominë pyjore: Shpat-1, ngastra 14/a dhe ekonominë pyjore F.Kuqe Zavalinë, ngastra 104/c.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Kriteret (a-c) janë vendosur në përputhje me Dokumentat e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr. 02 Datë 09.06.2021 si dhe bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”

Pika b) është vendosur në baze të nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojcës 9

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të leshuara nga administrate tatimore për gjatë tre viteve të fundit, 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të prokuruar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3 Operatori ekonomik të paraqesë një vërtetim që ka paguar taksat dhe tarifave vendore për vitin 2022 për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB-së). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetimin për taksat dhe tarifave vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave

vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit.

Kriteri **2.2.1** është përcaktuar duke u bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe referuar nënitet 42 pikë 3, 43 pikë 2/b dhe nënitet 47 VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në Nenin 77 pikë 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

Kriteri **2.2.2** është vendosur referuar nënitet 43, pikë 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në Nenin 77 pikë 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, nënitet 41, pikë c.

Kriteri **2.2.3** është vendosur bazuar në nenin 76, pikë 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së perlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Ne rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik**, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të leshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara,

ose

- b) **Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat**, si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Kriteri **2.3.1** është vendosur referuar nënitet 41 pikë 3 dhe 42 pikë 3 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe bazuar në nenin 77 pikë 4 të LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

2.3.2-Operatori ekonomik/ofertuesi duhet te paraqese Licencen Profesionale te shoqerise duke deshmuar qe zoteron keto kategori lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates:

Kodi III-7 A “shërbime të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me pyjet apo kullotat” lëshuar nga QKL

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ne VKM-ne Nr.538, date26.05.2009 "Per licencat dhelejettqetrajtohen ngaaponepermjet QKLdhedisarregullave tetjeranenligjore te perbashketa" e ndryshuar, per licencat e grupit te trete;

2.3.3- Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

LlojiMakinerive	Njesia	Sasia
Kamion transporti me kapacitet transporti mbi7 ton	copë	2
Fadrome/Eskavator/Traktor me thike	copë	1
Motorrsharre	copë	2

Tëgjithamjetet e lartpërmenduraduhettëjenëshoqëruar me fototpërkatëse.

Mjetet e lartpërmendura duhet të jenë në pronësi ose me qira dhe ofertuesi duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm:

a) Aktin e pronësisë së mjetit perkatës;

ose

b) Kontratën e marrjes me qira të mjetit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale e te perfshije afatin e realizimit te kesaj kontrate.

- Për mjetet ne pronesi ose te marra me qera si me lart që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, e vlefshme për të gjithë periudhen e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e mjeteve të mësipërme, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma ç,të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

1. Përcaktimin e numurit dhe llojit të mjeteve për mirmbajtjen e rrugëve auto ku do transportohet drut e zjarrit që nuk janë në vartësi të bashkisë.

Për të relizuar mirmbajtjen e rrugëve auto që do shërbejnë për transportin e druve të zjarrit, që nuk janë në vartësi të Bashkisë, por mirmbahen nga subjekti, nga pastrimi nga dëbora, nga rrëshqitjet e dherave, mbushjen e shtratit të rrugës ku krijohen gropa me çakell janë parashikuar këto mjete:

Për mirmbajtjen e rrugës Gjinar – Guri Kopil për ngastrën pyjore nr. 104/c, rruga kryesore e ekonomise pyjore ”Shpat-1” ngastra nr. 14/a ; si dhe për hapjen e rrugëve të brendëshme për secilën ngastër pyjore nevojitet një fadromë/ekskavator apo traktor me thikë.

Mbas rivlersimit të numurit të puntorëve, mjeteve të transportit dhe mjeteve për mirmbajtjen e rrugëve për kryerjen e shërbimit ”Prodhim, transport, stivim dru zjarri në fushën e Bashkisë”, për Lotin e I (parë) duhen:

1. Numuri mesatar i puntorëve i përcaktuar për kryerjen e këtij shërbimi është 9 puntorë.
2. Mjetet e transportit druve zjarrit nga ngastra për në fushën e bashkisë janë 2 kamion mbi 7 ton.
3. Mjet motorik për hapjen e rrugëve të brendëshme dhe mirmbajtjen e rrugës auto = 1 fadrom/ekskavator apo traktor me thikë.

2.3.4- Nje punësim mesatar prej prej **9** (nëntë) punonjës, per **3 muajt e fundit** të vërtetuar me;

- Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacionin e fuqipërperiudhen e kërkuar shoqëruar me formularet e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e fuqisë punetore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, gërma c, të VKMnr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me ane të këtij kriteri kërkohet që operoret ekonomike të deshmojnë që kanë fuqinë punetore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund të vihen.

Në përcaktimin e numurit mesatar të punonjësve prej 9 punonjës, janë analizuar:

1. Prodhimi dru zjarri me motosharrë nevojiten 6 (gjashtë) puntorë.

Në pyje operojnë brigata komplekse ku sipas librit të normave të shfrytëzimit pyjore në nr.operacionit 37/B-b (dru zjarri) dhe 28 (trupa dhe lënd ndertimi) norma ditore është 22 mst/8 orë dhe 29 m³/8 orë. Brigatat që kryejnë këtë shërbim janë komplekse dhe përbëhen nga 6 puntorë (1 motosharrist dhe 5 puntorë prodhimi).

Në raport me volumin prej 2724 mst dru zjarri dhe 319 m³ lënd punimi. Për këto volume dhe në raport me normat e punës të specifikuar në librin e normave të shfrytëzimit pyjor, për secilin nga asortimentet drusore sipërcituara, relativisht nevojitet një perudhë kohore prej 6 mujore, ku koha aktive e punës është 22 ditë në muaj për realizimin e këtij shërbimi nevojiten 6 puntorë.

2. Transport dru zjarri me kafshë dhe lëndë punimi me krahë, nevojiten 2 puntorë.

Në kryerjen e këtij shërbimi në pyje në llogaritjen e nr.puntorëve janë marrë për bazë distanca e transportit me kafshë, pjerrësia e terrenit dhe rezultoni që një puntor duke përfshirë edhe punën e kafshës, nxjerr në ditë afërsisht 6 - 9 mst/8 orë dru zjarri. Për transportin e volumit prej 2724 mst dru zjarri dhe 319 m³ (128 m³ me krahe), nevojiten rreth 16 muaj/1 punëtor, ku koha aktive e punës është 22 ditë në muaj, për realizimin e këtij shërbimi nevojiten rreth 2 puntorë për 8 muaj.

3. Ngarkim dru zjarri me krahë në automjet, shkarkim dru zjarri me krahë nga automjeti dhe stivim dru zjarri me krahë nevojiten 2 puntorë.

• **Ngarkim dru zjarri** me krahë në automjet.

Sipas librit të normave të shfrytëzimit pyjore në nr.operacionit 92 norma ditore është 18 mst/8orë. Për ngarkimin me krahë në automjet të volumit prej 2724 mst dru zjarri, për realizimin e këtij shërbimi, ku koha aktive e punës është 22 ditë në muaj, nevojiten 1 puntorë/ për 7 muaj.

• **Shkarkim dru zjarri** me krahë nga automjeti.

Sipas librit të normave të shfrytëzimit pyjore në nr. operacionit 103 norma ditore është 55 mst/8orë. Për shkarkimin druve të zjarrit me krahë nga automjeti të volumit prej 2724 mst dru zjarri, ku koha aktive e punës është 22 ditë në muaj, për realizimin e këtij shërbimi nevojitet 1 puntorë/ për 2 muaj.

• **Stivim dru zjarri** me krahë.

Sipas librit të normave të shfrytëzimit pyjore në nr. operacionit 114 norma ditore është 33 mst/8 orë. Për stivimin druve të zjarrit me krahë të volumit prej 2724 mst dru zjarri, ku koha aktive e punës është 22 ditë në muaj për realizimin e këtij shërbimi 1 puntorë për 4 muaj.

Si proces, nisur nga natyra që ka, dy puntorë e realizojnë plotësisht ngarkimin, shkarkimin dhe stivimin e druve të zjarrit dhe mbulohen me punë për kohën e përcaktuar për kryerjen e këtij shërbimi.

4. Pastrimi parces dhe grumbullim mbeturina togje nevojiten 2.6 puntorë.

Sipas librit të normave të shfrytëzimit pyjore në nr. operacionit 77 norma ditore është 0.08 ha/8orë. Për pastrimin e sipërfaqes dhe grumbullimin e mbeturinave në togje prej 46 ha, ku koha aktive e punës është 22 ditë në muaj, për realizimin e këtij operacioni për 10 muaj nevojiten 2.6 puntorë (ose 6 punëtorët prodhimit e realizojnë këtë proces për 4 muaj).

5. Transport dru zjarri me automjet nga ngastrat në fushën e Bashkisë Elbasan dhe manovrator për hapjen dhe mirmbajtjen e rrugëve nevojiten **1** puntorë (shofer).

Sasia e druve të zjarrit që do të transportohet me automjet është **2724** mst dru zjarri, ku koha aktive e punës është 22 dit/muaj dhe llogaritet afërsisht 10 muaj mbasi në muajt Janar – Mars nga bllokimi i rrugëve nga dëbora dhe ngrica nuk transportohet dhe pjesa tjetër e ditëve brenda 9 muajit punohet pjesërisht për shkak të ngricave reshjeve të dëborës shiut dhe difekteve teknike që pësojnë mjetet nga rrugët e vështira të pyllit. Pësia e druve të zjarrit për 1 Ton është 2.32 mst. Për të realizuar shërbimin e plotë të transportit të druve të zjarrit nga ngastrat për në fushën e Bashkisë, nevojiten **2** kamion (1 kamion në punë dhe 1 kamion në gadishmëri) me tonazh mbi 7 ton, duke transportuar afërsisht 16 mst dru zjarri në ditë për kamion, nevojitet **1** punonjës (shofer) për 8 muaj.

NË TOTAL NEVOJITEN:

6 - punëtorë që do të bëjnë prerjen dhe asortimin, do të bëjnë gjithashtu dhe pastrimin e parcelës (për një periudhë kohore afërsisht 10 muaj).

2 – Punëtor duhet për ngarkim, shkarkim dhe sistemim në fushën e bashkisë.

1 – punëtor duhet për transportin me automjet dhe si manovrator.

Theksojmë që numuri **9** i puntorëve të përcaktuar është numuri minimal për kryerjen e proceseve të këtij shërbimi, mbasi kryerja e proceseve të shërbimit është e kufizuar dhe varet nga ecuria e kushteve klimaterike, ngastrat pyjore të planifikuara për këtë aktivitet ndodhen në lartësi të madhe mbi nivelin e detit dhe gjendja teknike e rrugëve auto për transportin e druve të zjarrit është e shumë e keqe.

2.3.5- Operatori duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë nga Administratori i Shoqërisë, Drejtuesin Teknik, i cili duhet të jetë i profesionit Inxhinier Pyjesh për të cilin duhet të paraqesë: Kontrata pune, Lejen Profesionale të ushtrimit të profesionit, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë për **muajin e fundit**.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin drejtuesit teknik, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit.

Kriteri **2.3.5** është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit 77 të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të deklarojnë që kanë stafin teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Shënim: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 2.2.1 e pikës 2.2 - Kapaciteti ekonomik dhe financiar- të

kritereve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 2.3.1, 2.3.3 2.3.4 të pikës 2.3 -Kapaciteti Teknik- të kritereve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kritereve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në parashikimet e nenit 77, pika 3, të LPP-së dhe nenit 42, pika 8 të VKM nr.285, dt.19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet që nëse një operator ekonomik oferton për më shumë se një lot duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare si dhe kapacitetet teknike sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.

Loti II: “Shpenzime për prerje dhe transport dru zjarri” në ekonominë pyjore: Shpat-2, ngastra 31/a dhe ngastra 33/a

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Kriteret (a-c) janë vendosur ne perputhje me Dokumentat e Tenderit te miratuara nga APP bazuar ne Vendimit Nr. 02 Datë 09.06.2021 si dhe bazuar ne Ligjin Nr.162/2020 “Per prokurimin publik”

Pika b) eshte vendosur ne baze te nenit 30 pika 1 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojcës 9

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1 Kopje te deklaratave te xhiros vjetore te leshuara nga administrate tatimore pergjate tre viteve te fundit, 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete jo me e vogel se 40% vlerës se fondit limit te prokuruar.

2.2.2 Operatori ekonomik të paraqesë një vërtetim që ka paguar taksat dhe tarifave vendore për vitin 2022 për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB-së). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetimin për taksat dhe tarifave vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit.

Kriteri **2.2.1** është përcaktuar duke u bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe referuar nën 42 pika 3, 43 pika 2/c dhe nën 55 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

Kriteri **2.2.2** është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Ne rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin publik**, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të leshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasinë e mallrave të furnizuara,

ose

- c) **Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat**, si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Kriteri **2.3.1** është vendosur referuar nën 42 pika 3, dhe nën 55 pika 4/b të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në nenin 77 pika 4 të LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

2.3.2-Operatori ekonomik/ofertuesi duhet te paraqese Licencen Profesionale te shoqerise duke deshmuar qe zoteron keto kategori lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates:

Kodi III-7 A“shërbime të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me pyjet apo kullotat” lëshuar nga QKL

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ne VKM-ne Nr.538, date 26.05.2009 "Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregullave te tjera nenligjore te perbashketa" e ndryshuar, per licencat e grupit te trete;

2.3.3- Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

LlojiMakinerive	Njesia	Sasia
Kamion transporti me kapacitet transporti mbi7 ton	copë	2
Fadrome/Eskavator/Traktor me thike	copë	1
Motorrshare	copë	2

Të gjitha mjetet e lartpërmendura duhet të jenë shoqëruar me fototë përkatëse.

Mjetet e lartpërmendura duhet të jenë në pronësi ose me qira dhe ofertuesi duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm:

b) Aktin e pronësisë së mjetit përkatës;

ose

b) Kontratën e marrjes me qira të mjetit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale e te perfshije afatin e realizimit te kesaj kontrate.

- Për mjetet ne pronesi ose te marra me qera si me lart që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës

objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e mjeteve të mësipërme, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma ç, nenit 42 pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përcaktimin e numurit dhe llojit të mjeteve për mirmbajtjen e rrugëve auto ku do transportohet drut e zjarrit që nuk janë në vartësi të bashkisë.

Për të relizuar mirmbajtjen e rrugëve auto që do shërbejnë për transportin e druve të zjarrit, që nuk janë në vartësi të Bashkisë, por mirmbahen nga subjekti, nga pastrimi nga dëbora, nga rrëshqitjet e dherave, mbushjen e shtratit të rrugës ku krijohen gropa me çakell janë parashikuar këto mjete:

Për mirmbajtjen e rrugës Qaf Lesh – Prroi Qershisë për ngastrën pyjore nr. 31/a dhe 33/a; si dhe për hapjen e rrugëve të brendëshme për secilën ngastrë pyjore nevojitet një fadromë/ekskavator apo traktor me thikë.

Mbas rivlersimit të numurit të puntorëve, mjeteve të transportit dhe mjeteve për mirmbajtjen e rrugëve për kryerjen e shërbimit ”Prodhim, transport, stivim dru zjarri në fushën e Bashkisë”, për **Lotin e II (dytë) duhen:**

1. Numuri mesatar i puntorëve i përcaktuar për kryerjen e këtij shërbimi është **8** puntorë.
2. Mjetet e transportit druve zjarrit nga ngastra për në fushën e bashkisë janë **2** kamion mbi 7 ton.
3. Mjet motorik për hapjen e rrugëve të brendëshme dhe mirmbajtjen e rrugës auto = **1** fadrom/ekskavator apo traktor me thikë.

2.3.4- Nje punësim mesatar prej **8** (tetë) punonjës, për **3 muajt e fundit** të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar shoqëruar me formularet e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e fuqisë punëtore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, gërma c, nenit 42 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me ane të këtij kriteri kërkohej që opertoret ekonomike të deshmojnë që kanë fuqinë punetore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund të vihen.

Në përcaktimin e numurit mesatar të punonjësve prej 8 punonjës, janë analizuar:

1. Prodhimi dru zjarri me motosharrë nevojiten 6 (gjashtë) puntorë.

Në pyje operojnë brigata komplekse ku sipas librit të normave të shfrytëzimit pyjore në nr. operacionit 37/B-b (dru zjarri) dhe 28 (trupa dhe lëndë nderimi) norma ditore është 22 mst/8 orë dhe 29 m³/8 orë. Brigatat që kryejnë këtë shërbim janë komplekse dhe përbëhen nga 6 puntorë (1 motosharrist dhe 5 puntorë prodhimi).

Në raport me volumin prej 1298 mst dru zjarri dhe 292 m³ lëndë punimi. Për këto volume dhe në raport me normat e punës të specifikuar në librin e normave të shfrytëzimit pyjor, për secilin nga asortimentet drusore sipërcituara, relativisht nevojiten një periudhë kohore prej 3.2 mujore, ku koha aktive e punës është 22 ditë në muaj për realizimin e këtij shërbimi nevojiten 6 puntorë.

2. Transport dru zjarri me kafshë dhe lëndë punimi me krahë, nevojiten 2 puntorë.

Në kryerjen e këtij shërbimi në pyje në llogaritjen e nr. të puntorëve janë marrë për bazë distanca e transportit me kafshë, pjerrësia e terrenit dhe rezultojnë që një puntor duke përfshirë edhe punën e kafshës, nxjerr në ditë afërsisht 6 - 9 mst/8 orë dru zjarri. Për transportin e volumit prej 1298 mst dru zjarri dhe 292 m³ (117 m³ me krahe), nevojiten rreth 16 muaj/1 puntor, ku koha aktive e punës është 22 ditë në muaj, për realizimin e këtij shërbimi nevojiten rreth 1 puntorë për rreth 8 muaj.

3. Ngarkim dru zjarri me krahë në automjet, shkarkim dru zjarri me krahë nga automjeti dhe stivim dru zjarri me krahë nevojiten 2 puntorë.

- **Ngarkim dru zjarri me krahë në automjet.**

Sipas librit të normave të shfrytëzimit pyjore në nr. operacionit 92 norma ditore është 18 mst/8orë. Për ngarkimin me krahë në automjet të volumit prej 1298 mst dru zjarri, për realizimin e këtij shërbimi, ku koha aktive e punës është 22 ditë në muaj, nevojiten 1 puntorë/ për 3.3 muaj.

- **Shkarkim dru zjarri me krahë nga automjeti.**

Sipas librit të normave të shfrytëzimit pyjore në nr. operacionit 103 norma ditore është 55 mst/8orë. Për shkarkimin druve të zjarrit me krahë nga automjeti të volumit prej 1298 mst dru zjarri, ku koha aktive e punës është 22 ditë në muaj, për realizimin e këtij shërbimi nevojiten 1 puntorë/ për 1 muaj.

- **Stivim dru zjarri me krahë.**

Sipas librit të normave të shfrytëzimit pyjore në nr. operacionit 114 norma ditore është 33 mst/8 orë. Për stivimin druve të zjarrit me krahë të volumit prej 1298 mst dru zjarri, ku koha aktive e punës është 22 ditë në muaj për realizimin e këtij shërbimi 1 puntorë për rreth 2 muaj.

Proceset e shërbimit ngarkim, shkarkim dru zjarri me krah nga automjeti dhe stivim dru zjarri me krahë janë planifikuar sipas grafikut të kryhen për periudhë 10 mujore mbasi për periudhën Janar - Shkurt mjetet e transportit nuk futen për ngarkesë në ngastrat pyjore.

4. Pastrimi parces dhe grumbullim mbeturina togje nevojiten 1 puntorë.

Sipas librit të normave të shfrytëzimit pyjore në nr. operacionit 77 norma ditore është 0.08 ha/8orë. Për pastrimin e sipërfaqes dhe grumbullimin e mbeturinave në togje prej 14 ha, ku koha aktive e

punës është 22 ditë në muaj, për realizimin e këtij operacioni për 10 muaj nvojiten **1 puntorë** (ose 6 punëtorët prodhimit e realizojnë këtë proces për rreth **1 muaj**).

5. Transport dru zjarri me automjet nga ngastrat në fushën e Bashkisë Elbasan dhe manovrator për hapjen dhe mirmbajtjen e rrugëve nevojiten **1 puntorë (shofer).**

Sasia e druve të zjarrit që do të transportohet me automjet është **1298** mst dru zjarri, ku koha aktive e punës është 22 ditë/muaj dhe llogaritet afërsisht 10 muaj mbasi në muajt Janar – Mars nga bllokimi i rrugëve nga dëbora dhe ngrica nuk transportohet dhe pjesa tjetër e ditëve brenda 9 muajit punohet pjesërisht për shkak të ngricave reshjeve të dëborës shiut dhe difekteve teknike që pësojnë mjetet nga rrugët e vështira të pyllit. Pesa e druve të zjarrit për 1 Ton është 2.32 mst. Për të realizuar shërbimin e plotë të transportit të druve të zjarrit nga ngastra për në fushën e Bashkisë, nevojiten **2** kamion (1 kamion në punë dhe 1 kamion në gadishmëri) me tonazh mbi 7 ton, duke transportuar afërsisht 16 mst dru zjarri në ditë për kamion, nevojitet **1** punonjës (shofer) për rreth **5** muaj.

NË TOTAL NEVOJITEN.

6 - punëtorë që do të bëjnë prerjen dhe asortimin, do të bëjnë gjithashtu dhe pastrimin e parcelës (për një periudhë kohore afërsisht **5 muaj).**

1 – Punëtor duhet për ngarkim, shkarkim dhe sistemim në fushën e bashkisë. Në ngarkim do të marrin pjesë dhe punëtorët e prodhimit.

1 – punëtor duhet për transportin me automjet dhe si manovrator.

Theksojmë që numuri **8** i puntorëve të përcaktuar është numuri minimal për kryerjen e proceseve të këtij shërbimi, mbasi kryerja e proceseve të shërbimit është e kufizuar dhe varet nga ecuria e kushteve klimaterike, ngastrat pyjore të planifikuara për këtë aktivitet ndodhen në lartësi të madhe mbi nivelin e detit dhe gjendja teknike e rrugëve auto për transportin e druve të zjarrit është e shumë e keqe.

2.3.5- Operatori duhet të percaktojë me anë të një deklaratë nga Administratori i Shoqërisë, Drejtuesin Teknik, i cili duhet të jetë i profesionit Inxhinier Pyjesh për të cilin duhet të paraqesë: Kontratë pune, Lejen Profesionale të ushtrimit të profesionit, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë për **muajin e fundit**.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin drejtuesit teknik, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit.

